



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

VENDIM

Nr. 2 Data 03.10.2017

Për miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit uJOR në përroin e Gurrës, dega e lumit Drinos, për ndërtimin e hidrocentralit "Humelicë" për prodhim të energjisë elektrike, Rrethi Gjirokastër, qarku Gjirokastër, subjektit "GJEOKONSULT&CO" sh.p.k., me administrator Z. Hamit MUSTAFA.

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta", Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit UJOR", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit UJOR"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, **Nr. 526, datë 21.10.2016 "Vënie në dijeni"**,

VENDOSI

Miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit uJOR në përroin e Gurrës, dega e lumit Drinos, për ndërtimin e hidrocentralit "Humelicë" për prodhim të energjisë elektrike, Rrethi Gjirokastër, qarku Gjirokastër, subjektit "GJEOKONSULT&CO" sh.p.k., me administrator Z. Hamit MUSTAFA me këto të dhëna:

Koordinatat: X 4419503.795; Y 4448025.059; Z 265.00

Prurja mesatare: 1.491 m³/sek

Prurja e llogaritur: 2.392 m³/sek

Prurja e ekologjike: 0.24 m³/sek

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritet të jetë **1730 kW**

Afati i autorizimit 1 vit.

Për përdorimin e këtij burimi ujqor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e autorizimit.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U “VJOSË”

Ilir PROFKA



KRYETAR I K.B.U “VJOSË”

Etjona HOXHA

